R E L A C I O N
S H O Q Ë R U E S

PËR

PROJEKTLIGJIN "PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE MINERARE"

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i hartimit të projektligjit "Për menaxhimin e mbetjeve minerare" është krijimi i një kuadri ligjor të plotë, të specializuar dhe të harmonizuar për menaxhimin e mbetjeve minerare në Republikën e Shqipërisë, me synim: parandalimin ose pakësimin e krijimit të mbetjeve minerare dhe të ndikimeve negative të tyre në mjedis dhe në shëndetin e njeriut; garantimin e depozitimit të sigurt të mbetjeve minerare gjatë gjithë ciklit të jetës së tyre, përfshirë edhe fazën e pasmbylljes; promovimin e ripërdorimit, riciklimit dhe shfrytëzimit të mbetjeve minerare si burim dytësor; parandalimin e aksidenteve të rënda nga objektet e mbetjeve minerare dhe minimizimin e pasojave të tyre; si dhe sigurimin e rikultivimit dhe rehabilitimit të territorit të prekur nga veprimtaritë minerare.

Kuadri ligjor në fuqi rregullon menaxhimin e mbetjeve minerare vetëm në mënyrë të fragmentuar. Ligji nr. 10304, datë 15.07.2010, "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, parashikon plane menaxhimi të mbetjeve dhe garanci financiare për rehabilitimin e mjedisit, por nuk përcakton kritere të qarta klasifikimi të objekteve sipas nivelit të rrezikut, kërkesa të detajuara për projektimin, ndërtimin, operimin, mbylljen dhe pasmbylljen e objekteve të mbetjeve minerare, detyrime të qarta për parandalimin e aksidenteve të rënda dhe menaxhimin e emergjencave, apo mekanizma të strukturuar për informimin dhe pjesëmarrjen e publikut.

Projektligji rregullon të gjithë ciklin e jetës së mbetjeve minerare, nga parandalimi i krijimit të tyre, karakterizimi, depozitimi, trajtimi dhe asgjësimi i sigurt, deri te mbyllja, pasmbyllja, rehabilitimi i territoreve të prekura dhe trajtimi i trashëgimisë së objekteve të mbyllura e të braktisura, duke vendosur detyrime të qarta dhe të

matshme për operatorët, si dhe role dhe përgjegjësi të qarta për institucionet publike përgjegjëse për lejimin, inspektimin dhe monitorimin.

Objektivat konkretë që synon të arrijë projektligji janë si më poshtë:

- Përafrimi i legjislacionit vendor me acquis communautaire: përafrimi i plotë i legjislacionit shqiptar me Direktivën 2006/21/KE dhe aktet lidhëse të Bashkimit Evropian, si pjesë e përmbushjes së detyrimeve të Shqipërisë në procesin e integrimit evropian, veçanërisht në kuadër të kapitullit 27 të negociatave për anëtarësim.
- Parandalimi ose pakësimi i krijimit të mbetjeve minerare: krijimi i një kuadri ligjor i cili nxit operatorët që në fazën e projektimit të veprimtarive minerare, të zgjedhin metoda dhe teknologji që minimizojnë sasinë dhe rrezikshmërinë e mbetjeve të krijuara.
- Garantimi i depozitimit të sigurt të mbetjeve minerare: vendosja e kërkesave të detajuara për projektimin, ndërtimin, operimin, mbylljen dhe monitorimin e objekteve të mbetjeve minerare, në mënyrë që stabiliteti fizik dhe kimik i tyre të garantohet gjatë gjithë ciklit të jetës, përfshirë fazën e pasmbylljes.
- Promovimi i ripërdorimit, riciklimit dhe shfrytëzimit të mbetjeve si burim dytësor: nxitja e shfrytëzimit të mbetjeve minerare në frymën e ekonomisë qarkulluese, duke reduktuar sasinë e mbetjeve që depozitohen dhe duke krijuar vlerë ekonomike nga burimet dytësore.
- Parandalimi i aksidenteve të rënda dhe menaxhimi i emergjencave: vendosja e detyrimeve për hartimin e politikës për parandalimin e aksidenteve të rënda, të sistemit të menaxhimit të sigurisë dhe të planeve të brendshme e të jashtme të emergjencës, për objektet me rrezik të lartë.
- Klasifikimi i objekteve sipas nivelit të rrezikut: krijimi i një sistemi klasifikimi të objekteve të mbetjeve minerare në Kategorinë A (objekte me rrezik të lartë aksidentesh të rënda) dhe Kategorinë B, që mundëson diferencimin e kërkesave dhe të intensitetit të mbikëqyrjes sipas rrezikut real.

- Sigurimi i garancive financiare: detyrimi për vendosjen e garancive financiare përpara fillimit të veprimtarisë, të mjaftueshme për të mbuluar rehabilitimin, rikultivimin, mbylljen dhe monitorimin pas mbylljes, në mënyrë që kostot të mos bartet mbi shtetin, në zbatim të parimit "ndotësi paguan".
- Rehabilitimi dhe rikultivimi i territoreve të prekura: sigurimi i rikthimit të territoreve të prekura nga veprimtaritë minerare në gjendje të sigurt dhe, kur është e mundur, në përdorime të dobishme për komunitetet.
- Forcimi i inspektimit, monitorimit dhe raportimit: krijimi i një sistemi të rregullt inspektimesh gjashtëmujore, raportimi periodik nga operatorët dhe administrimi i informacionit nga struktura përgjegjëse.
- Informimi dhe pjesëmarrja e publikut: sigurimi i aksesit të publikut në informacionin për objektet e mbetjeve minerare, veçanërisht për ato të Kategorisë A, si dhe i pjesëmarrjes së tij në proceset vendimmarrëse.
- Trajtimi i trashëgimisë minerare: krijimi i inventarit kombëtar të objekteve të mbyllura dhe të braktisura të mbetjeve minerare dhe i mekanizmave për vlerësimin e rrezikut dhe marrjen e masave për monitorimin, rehabilitimin dhe sigurimin e tyre.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Miratimi i këtij projektligji nuk është planifikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2026, për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Miratimi i këtij projektligji mbështetet në dokumentet kryesore të politikave kombëtare në fushën e sektorit minerar, të mbrojtjes së mjedisit dhe të integrimit evropian, përfshirë Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian, Planin Kombëtar për Integrimin Evropian, si dhe dokumentet sektoriale të politikave minerare dhe të menaxhimit të mbetjeve. Këto dokumente evidentojnë vazhdimisht nevojën për forcimin e kuadrit ligjor dhe institucional për menaxhimin e sigurt të mbetjeve minerare, për trajtimin e trashëgimisë së objekteve të braktisura

dhe për nxitjen e shfrytëzimit të mbetjeve si burime dytësore, në frymën e ekonomisë qarkulluese dhe të zhvillimit të qëndrueshëm.

Ky projektligj është përafruar plotësisht me Direktivën 2006/21/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 15 mars 2006, "Për menaxhimin e mbetjeve nga industritë nxjerrëse", e cila ndryshon Direktivën 2004/35/KE. Detajet janë në tabelat e përputhshmërisë.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Nevoja për hartimin e këtij projektligji lind, së pari, nga angazhimi i Shqipërisë për të harmonizuar legjislacionin e saj kombëtar me atë të Bashkimit Evropian.

Së dyti, menaxhimi i mbetjeve minerare rregullohet sot kryesisht përmes ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010, "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, i cili i trajton këto çështje vetëm në mënyrë anësore, si pjesë e rregullimit të përgjithshëm të veprimtarive minerare. Mungesa e një ligji të vecantë ka bërë që një sërë çështjesh thelbësore, si klasifikimi i objekteve sipas rrezikut, kërkesat për karakterizimin e mbetjeve, kërkesat teknike për ndërtimin dhe operimin e objekteve, detyrimet për fazën e pasmbylljes, planet e emergjencës dhe informimi i publikut të të rregullohen në mënyrë të paqartë dhe praktikisht të pazbatueshme.

Së treti, një problematikë e veçantë paraqet trashëgimia e sektorit minerar. Në territorin e vendit ndodhen objekte të mbyllura dhe të braktisura të mbetjeve minerare, të krijuara kryesisht gjatë periudhës së ndërmarrjeve shtetërore minerare. Aktualisht ekziston vetëm një inventar i fragmentuar sipas shoqërive, të tilla si "Albkrom" sh.a., "Albbaker" sh.a., "Albminiera" sh.a., si dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore dhe për këto objekte shpesh mungon një përgjegjës i qartë ligjor, ndërsa rreziqet për stabilitetin strukturor, për ndotjen e ujërave sipërfaqësore e nëntokësore dhe për shëndetin e komuniteteve përreth mbeten reale. Mungesa e një inventari kombëtar të përditësuar dhe e mekanizmave ligjorë për vlerësimin e rrezikut dhe marrjen e masave e bën të vështirë prioritizimin e ndërhyrjeve dhe përdorimin efikas të burimeve publike.

Së katërti, përvoja ndërkombëtare dhe rajonale ka vërtetuar se aksidentet në objektet e mbetjeve minerare, sidomos shembja e digave të pellgjeve të sterileve, janë ndër ngjarjet më katastrofike mjedisore, me pasoja afatgjata dhe shpesh ndërkufitare. Mungesa e kërkesave ligjore për politikën e parandalimit të aksidenteve të rënda, sistemet e menaxhimit të sigurisë dhe planet e brendshme e të jashtme të emergjencës e ekspozon vendin ndaj rreziqeve të ngjashme, sidomos në zonat ku operojnë impiante të mëdha përpunimi.

Së pesti, mungesa e mekanizmave të qarta për informimin dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen për objektet e mbetjeve minerare nuk i përgjigjet detyrimeve të Shqipërisë që rrjedhin nga Konventa e Aarhus-it për aksesin në informacion, pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe aksesin në drejtësi për çështjet mjedisore, si dhe pritshmërive të ligjshme të komuniteteve që jetojnë pranë këtyre objekteve.

Efektet e pritshme nga miratimi i këtij projektligji janë shumëdimensionale: rritje e sigurisë për komunitetet që jetojnë pranë objekteve të mbetjeve minerare; mbrojtje më efektive e ujërave sipërfaqësore e nëntokësore, e tokës dhe e ajrit; krijim i një kuadri të qartë dhe të parashikueshëm për investitorët në sektorin minerar; forcimi i kapaciteteve institucionale të mbikëqyrjes; reduktimi i kostove të ardhshme për buxhetin e shtetit nga rehabilitimet e pafinancuara; si dhe përparimi i matshëm i Shqipërisë në përmbushjen e detyrimeve të procesit të integrimit evropian.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji i propozuar është në harmoni me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Nisja dhe miratimi i tij respektojnë nenet 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës. Më tej, projektligji i jep zbatim konkret të drejtës së çdo personi për t'u informuar për gjendjen e mjedisit dhe mbrojtjen e tij, të garantuar nga neni 56 i Kushtetutës, si dhe objektivit kushtetues për mbrojtjen e mjedisit të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezin e sotëm dhe për brezat e ardhshëm, të parashikuar në nenin 59 të Kushtetutës.

Projektligji është në përputhje me legjislacionin në fuqi, veçanërisht me: ligjin nr. 10304, datë 15.07.2010, "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dispozitat e të cilit për menaxhimin e mbetjeve minerare ndryshohen ose shfuqizohen shprehimisht me këtë ligj.

Në planin ndërkombëtar, projektligji është në përputhje me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian; me Konventën "Për aksesin në informacion, pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe aksesin në drejtësi për çështjet mjedisore" (Konventa e Aarhus-it), për sa i përket informimit dhe pjesëmarrjes së publikut; si dhe me Konventën "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis në një kontekst ndërkufitar" (Konventa e Espoo-së), për sa i përket efekteve ndërkufitare të mundshme të objekteve të mbetjeve minerare.

Projektligji nuk kundërshton asnjë dispozitë tjetër ligjore në fuqi. Për çdo rast mospërputhjeje të mundshme midis këtij ligji dhe akteve nënligjore në fuqi, neni 35 i projektligjit parashikon shprehimisht përparësinë e dispozitave të tij.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj është përafruar plotësisht me Direktivën 2006/21/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 15 mars 2006, "Për menaxhimin e mbetjeve nga industritë nxjerrëse", të botuar në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian L 102, datë 11.4.2006, fq. 15–34..

Elementet kryesore të Direktivës 2006/21/KE janë reflektuar në projektligj, përfshirë: fushën e zbatimit dhe përjashtimet; përkufizimet; klasifikimin e objekteve të mbetjeve minerare sipas nivelit të rrezikut, përfshirë konceptin e objekteve të Kategorisë A; kërkesat e përgjithshme për menaxhimin e mbetjeve minerare dhe për planin e menaxhimit të tyre; sistemin e lejimit; kërkesat për parandalimin e aksidenteve të rënda dhe informimin e publikut, përfshirë politikën për parandalimin e aksidenteve të rënda, sistemin e menaxhimit të sigurisë dhe planet e brendshme e të jashtme të emergjencës; garancinë financiare; kërkesat për ndërtimin, operimin, mbylljen dhe pasmbylljen e objekteve; mbrojtjen e ujërave

dhe kufizimin e përqendrimit të cianurit; efektet ndërkufitare; inspektimet dhe raportimin; si dhe inventarin e objekteve të mbyllura dhe të braktisura.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji ndahet në njëmbëdhjetë krerë dhe dy anekse, që janë pjesë përbërëse e tij. Një përmbledhje e propozimeve kryesore të paraqitura nga projektligji paraqitet më poshtë, e organizuar sipas krerëve dhe neneve të projektligjit.

- **KREU I "DISPOZITA TË PËRGJITHSHME"**

Ky kre përfshin dispozitat themelore të ligjit: qëllimin, fushën e zbatimit, përkufizimet, parimet e përgjithshme dhe sistemin e klasifikimit të objekteve të mbetjeve minerare.

Neni 1 përcakton qëllimin e ligjit, që është krijimi i një sistemi të menaxhimit të mbetjeve minerare për të: parandaluar ose pakësuar krijimin e mbetjeve minerare dhe ndikimet negative të tyre në mjedis dhe shëndetin e njeriut; garantuar depozitimin e sigurt të mbetjeve minerare gjatë gjithë ciklit të jetës së tyre, përfshirë edhe fazën e pasmbylljes; promovuar ripërdorimin, riciklimin dhe shfrytëzimin e tyre si burim dytësor; parandaluar aksidentet e rënda nga objektet e mbetjeve minerare dhe minimizuar pasojat e tyre; si dhe siguruar rikultivimin dhe rehabilitimin e territorit të prekur nga veprimtaritë minerare.

Neni 2 përcakton fushën e zbatimit të ligjit. Objekti i ligjit përfshin parandalimin ose pakësimin e krijimit të mbetjeve minerare; depozitimin, trajtimin dhe asgjësimin e sigurt të tyre; klasifikimin e objekteve të mbetjeve minerare sipas nivelit të rrezikut; parandalimin e aksidenteve të rënda dhe menaxhimin e emergjencave; rehabilitimin e territoreve të prekura; si dhe monitorimin e pasmbylljes dhe kujdesin e mëtejshëm. Ligji zbatohet për mbetjet që krijohen gjatë kërkim-zbulimit të vendburimeve minerale, nxjerrjes, shfrytëzimit dhe përpunimit të mineraleve dhe të torfës, si dhe gjatë depozitimit dhe menaxhimit të mbetjeve minerare.

Neni 3 përmban përkufizimet e nevojshme për zbatimin e ligjit. Numri i përkufizimeve është i konsiderueshëm, 36 terma, duke reflektuar natyrën teknike

të fushës dhe duke siguruar që çdo koncept i përdorur në ligj të ketë një kuptim të qartë dhe të unifikuar. Ndër përkufizimet kryesore përmenden: “objekt mbetjesh minerare”, i përkufizuar si çdo zonë e caktuar për grumbullimin ose depozitimin e mbetjeve minerare, me periudha kohore të diferencuara sipas natyrës dhe rrezikshmërisë së mbetjeve, duke përfshirë digat, stoqet dhe pellgjet; “mbetje inerte”, në përputhje me kriteret e legjislacionit mjedisor; “aksident i rëndë”; “integritet strukturor” dhe “humbje e integritetit strukturor”, që përbëjnë bazën e mbikëqyrjes teknike; “teknikat më të mira të disponueshme”, si standard reference për masat e operatorit; “garancia financiare”; “struktura përgjegjëse”, në varësi të ministrit përgjegjës për veprimtarinë minerare, e cila ushtron funksionet e monitorimit dhe inspektimit; “person kompetent”, për projektimin, monitorimin dhe vlerësimin e sigurisë së objekteve; “rehabilitim progresiv” dhe “rehabilitim përfundimtar”; “cianur i disociueshëm në acid të dobët”, për zbatimin e kufizimeve përkatëse; “trup pritës i ujërave”; si dhe “publiku i interesuar” dhe “autoriteti kompetent”, ky i fundit i definuar në lidhje me ligjin për vlerësimin e ndikimit në mjedis.

Neni 4 përcakton parimet e përgjithshme të menaxhimit të mbetjeve minerare: parimin e parandalimit; parimin “ndotësi paguan”, sipas të cilit kostot e menaxhimit mbulohen nga operatori; parimin e zhvillimit të qëndrueshëm; parimin e afërsisë, sipas të cilit mbetjet menaxhohen në vendin ku krijohen, kur kjo është e mundur dhe e përshtatshme për mjedisin; parimin e sigurisë, që kërkon që objektet të projektohen, ndërtohen, operohen dhe mbyllen në mënyrë të sigurt; parimin e transparencës, që garanton informimin e publikut; si dhe pjesëmarrjen e njësive vendore gjatë procesit të konsultimit publik.

Neni 5 përcakton sistemin e klasifikimit të objekteve të mbetjeve minerare në dy kategori: Kategorinë A — objektet me rrezik të lartë të aksidenteve të rënda — dhe Kategorinë B — objektet që nuk plotësojnë kushtet për klasifikim në Kategorinë A. Klasifikimi në Kategorinë A bazohet në vlerësimin e rrezikut dhe, kur është e zbatueshme, në vlerësimin e kryer nga një person i autorizuar ose institucion i autorizuar, duke marrë parasysh madhësinë dhe vendndodhjen e objektit, ndikimin e mundshëm në mjedis, si dhe sasinë e mbetjeve minerare të rrezikshme ose vëllimin e substancave dhe përbërjeve kimike të rrezikshme të përmbajtura në to.

- **KREU II “MENAXHIMI I MBETJEVE MINERARE”**

Ky kre rregullon kërkesat e përgjithshme për menaxhimin e mbetjeve minerare, planin e menaxhimit dhe regjimin e lejes, përfshirë dhënien, ndryshimin dhe transferimin e saj.

Neni 6 përcakton kërkesat e përgjithshme për menaxhimin e mbetjeve minerare. Operatori është i detyruar të mos rrezikojë jetën dhe shëndetin e banorëve të zonës; të mos përdorë procese dhe metoda që dëmtojnë mjedisin, veçanërisht sa i përket cilësisë së ujit, ajrit ose tokës; të mos shkaktojë shqetësim nga zhurma ose era mbi masën e përcaktuar; si dhe të mos shkaktojë ndikim negativ në peizazh, bimë, kafshë, zona të veçanta të mbrojtura, rezervate dhe monumente kulture.

Neni 7 përcakton planin e menaxhimit të mbetjeve minerare, që përbën instrumentin kryesor operativ të operatorit. Plani hartohet me qëllim minimizimin e krijimit të mbetjeve minerare, përpunimin, shfrytëzimin dhe asgjësimin e tyre dhe duhet të përmbajë kushte për: parandalimin e krijimit të mbetjeve, duke marrë parasysh ndikimin e metodës së nxjerrjes dhe përpunimit që në fazën e projektimit, ndryshimet e mundshme të mbetjeve nga ekspozimi sipërfaqësor, mundësinë e mbushjes së hapësirave të nxjerra me mbetje minerare, kur kjo është teknikisht dhe ekonomikisht e zbatueshme dhe e mirë për mjedisin, mundësinë e rikthimit të shtresës së kulturave bujqësore të tokës, si dhe kufizimin e përdorimit të substancave dhe përbërjeve të rrezikshme gjatë përpunimit; sigurimin e depozitimit të sigurt, përmes zgjedhjes së një projekti që parashikon kërkesa minimale për monitorimin e vendit të mbyllur, parandalon efektet afatgjata të pafavorshme dhe siguron qëndrueshmërinë gjeoteknike afatgjatë; nxitjen e shfrytëzimit të mbetjeve minerare; vendndodhjen e vendit të depozitimit, përfshirë alternativat; rehabilitimin dhe rikultivimin e territorit të prekur; si dhe depozitimin e mbetjeve sipas llojit dhe vetive të tyre.

Neni 8 përcakton se leja për menaxhimin e mbetjeve minerare miratohet nga Ministri dhe lëshohet nga Qendra Kombëtare e Biznesit, në përputhje me ligjin nr. 10 081, datë 23.02.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe përfshihet në kategorinë IV.1 të shtojcës së këtij ligji. Duke pasur parasysh rreziqet potenciale të veprimtarisë, për këtë leje nuk zbatohet parimi i miratimit në heshtje. Vendimi përfundimtar i miratimit njoftohet dhe hyn

në fuqi në datën e publikimit në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve.

Neni 9 përcakton rastet dhe procedurën e ndryshimit të kushteve të lejes. Operatori kërkon ndryshimin e lejes kur ka ndryshime në përbërjen e mbetjeve ose në operimin, si dhe kur monitorimi tregon ndryshime që ndikojnë në sigurinë. Struktura përgjegjëse mund të nisë procedurën e ndryshimit të kushteve të lejes edhe kur operatori nuk e ka kërkuar ndryshimin e detyrueshëm, duke siguruar kështu që leja të reflektojë gjithmonë gjendjen reale të objektit. Procedura e ndryshimit ndjek të njëjtat hapa si procedura e marrjes së lejes fillestare.

Neni 10 rregullon transferimin e të drejtave të lejes. Lejet e menaxhimit të mbetjeve minerare janë të transferueshme vetëm pas miratimit paraprak të ministrit dhe çdo transferim i kryer pa këtë miratim është i pavlefshëm, kërkesë e domosdoshme për të garantuar që përgjegjësitë për objektet me rrezik të kalojnë vetëm te subjekte të vlerësuara paraprakisht. Miratimi ose refuzimi i ministrit bëhet brenda 60 ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së kërkesës. Ndërtimet dhe instalimet e tjera që mbështesin operacionet kryesore vlerësohen si veprimtari ndihmëse të pandashme të së drejtës së lejes dhe transferohen bashkë me të.

Neni 11 përcakton ndarjen e përgjegjësive në rast transferimi: transferuesi i lejes përgjigjet për të gjitha detyrimet ndaj shtetit deri në çastin e transferimit, ndërsa përfituesi i lejes përgjigjet për të gjitha detyrimet ndaj shtetit pas transferimit. Transferuesi siguron dorëzimin e plotë, te zotëruesi i ri i lejes, të dokumentacionit, regjistrave dhe informacionit të përditësuar që lidhet me objektin e mbetjeve minerare, duke garantuar vazhdimësinë e menaxhimit të sigurt.

- **KREU III "INFORMIMI DHE KONSULTIMI"**

Ky kre, i përbërë nga neni 12, rregullon pjesëmarrjen e publikut dhe konsultimin, në përputhje me parimet e Konventës së Aarhus-it dhe me kërkesat e Direktivës 2006/21/KE për informimin e publikut për objektet e Kategorisë A.

Neni 12 përcakton se struktura përgjegjëse siguron, nëpërmjet portalit të administratës publike dhe takimeve me publikun e interesuar, informimin për objektet e Kategorisë A në kuadër të procedurës së lejimit, për: kërkesën për leje; dokumentet bazë për vendimin që do të lëshohet; faktin nëse vendimi për lejimin i

nënshtrohet konsultimit midis shteteve ndërkufitare; organet nga të cilat mund të merret informacion dhe afatet për dorëzimin e vërejtjeve dhe pyetjeve; propozimet për ndryshimin e lejes ose të kushteve të saj; si dhe propozimin e vendimit për lejimin e operimit të vendit të depozitimit dhe ndryshimet në të.

- **KREU IV "NDËRTIMI, OPERIMI, MBYLLJA DHE PASMBYLLJA E OBJEKTEVE TË MBETJEVE MINERARE"**

Ky kre përcakton kërkesat teknike për gjithë ciklin e jetës fizik të objektit, nga projektimi dhe ndërtimi deri te kujdesi pas mbylljes.

Neni 13 përcakton kërkesat për ndërtimin dhe menaxhimin e objekteve të mbetjeve minerare. Operatori projekton, ndërton, operon, mirëmban, mbyll dhe monitoron objektin në mënyrë që të garantohet stabiliteti fizik dhe kimik i tij, të parandalohet ndotja e mjedisit dhe të mbrohet shëndeti i njerëzve gjatë gjithë ciklit të jetës së objektit. Gjatë projektimit dhe operimit merren parasysh veçanërisht: karakteristikat gjeologjike, hidrologjike, hidrogjeologjike, sizmike dhe gjeoteknike të zonës; vendndodhja dhe ndikimi i mundshëm i objektit mbi mjedisin dhe popullsinë; karakteristikat fizike dhe kimike të mbetjeve minerare; parandalimi i ndotjes së tokës, ujërave sipërfaqësore e nëntokësore dhe ajrit; kufizimi i erozionit dhe i përhapjes së pluhurit; si dhe përdorimi i teknikave më të mira të disponueshme.

Neni 14 rregullon mbylljen e objektit të mbetjeve minerare. Mbyllja kryhet në përputhje me kushtet e lejes, planin e menaxhimit të mbetjeve minerare dhe planin e rehabilitimit. Operatori paraqet pranë strukturës përgjegjëse kërkesën për miratimin e mbylljes, të shoqëruar me dokumentacionin teknik që provon përmbushjen e kushteve të përcaktuara në leje. Ministri miraton mbylljen vetëm pasi struktura përgjegjëse, nëpërmjet verifikimeve dhe inspektimeve të nevojshme, konstaton dhe raporton se janë përmbushur kushtet e ligjit dhe të lejes. Me këtë formulim, mbyllja nuk është një akt njëanshëm i operatorit, por një procedurë e kontrolluar nga shteti.

Neni 15 përcakton detyrimet gjatë periudhës së pasmbylljes. Pas miratimit të mbylljes, operatori mbetet përgjegjës për monitorimin, mirëmbajtjen dhe kontrollin e objektit për aq kohë sa ai mund të paraqesë rrezik për shëndetin e njerëzve ose

mjedisin, 10 vite për objektet e Kategorisë A dhe 5 vite për objektet e Kategorisë B. Operatori monitoron periodikisht stabilitetin fizik dhe kimik të objektit dhe ndikimin e tij mbi tokën, ujërat sipërfaqësore, ujërat nëntokësore dhe mjedisin; nëse konstatohen zhvillime që mund të ndikojnë në sigurinë e objektit ose të shkaktojnë ndotje të mjedisit, merr menjëherë masat korrigjuese, zbaton planin e emergjencës dhe njofton strukturën përgjegjëse, duke përballuar kostot e masave.

- **KREU V "PARANDALIMI I AKSIDENTEVE TË RËNDA"**

Ky kre, i përbërë nga neni 16, zbatohet për objektet e mbetjeve minerare të Kategorisë A dhe pasqyron kërkesat përkatëse të Direktivës 2006/21/KE.

Neni 16 i detyron operatorët e objekteve të Kategorisë A të marrin të gjitha masat e nevojshme për identifikimin e rreziqeve të aksidenteve të rënda dhe të sigurojnë që kërkesat për parandalimin e tyre të integrohen në projektimin, ndërtimin, funksionimin, mirëmbajtjen, mbylljen dhe periudhën pas mbylljes së objektit. Përpara fillimit të veprimtarisë, operatori harton politikën për parandalimin e aksidenteve të rënda, zbaton sistemin e menaxhimit të sigurisë dhe harton planin e brendshëm të emergjencës, duke caktuar personin përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin periodik të politikës; politika dhe sistemi hartohen në përputhje me Aneksin I të ligjit.

- **KREU VI "MBROJTJA E MJEDISIT"**

Neni 17 përcakton kërkesat për mbrojtjen e ujërave, tokës dhe mjedisit. Operatori merr të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar ose, kur kjo nuk është e mundur, për të minimizuar ndikimet negative të objektit mbi tokën, ujërat sipërfaqësore, ujërat nëntokësore dhe mjedisin. Projektimi, ndërtimi, operimi, mbyllja dhe pasmbyllja e objektit duhet të sigurojnë: parandalimin ose minimizimin e formimit dhe përhapjes së infiltrimeve; mbledhjen, kontrollin dhe trajtimin e infiltrimeve dhe ujërave të ndotura; parandalimin e ndotjes së tokës dhe të ujërave; si dhe kontrollin e bilancit të ujit në objekt.

Neni 18 rregullon efektet ndërkufitare, në përputhje me detyrimet ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë. Kur autoriteti kompetent vlerëson se funksionimi i një objekti depozitimi të mbetjeve minerare mund të ketë efekte të rëndësishme negative në mjedisin ose shëndetin e njerëzve në territorin e një shteti tjetër, ose

kur një shtet tjetër paraqet kërkesë për informacion, autoriteti kompetent bashkëpunon me autoritetet kompetente të shtetit të prekur, duke i siguruar informacionin përkatës lidhur me kërkesën për miratim, ndryshimin ose funksionimin e objektit dhe duke siguruar shkëmbimin e informacionit dhe konsultimin për vlerësimin e ndikimeve të mundshme ndërkufitare dhe përcaktimin e masave parandaluese ose korrigjuese.

Neni 19 rregullon mbushjen e hapësirave të krijuara nga nxjerrja e mineraleve me mbetje minerare. Operatori që përdor këto hapësira për depozitimin e mbetjeve duhet të sigurojë stabilitetin e tyre dhe të mbetjeve të depozituara, parandalimin e ndotjes së tokës, të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, si dhe mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe mjedisit gjatë funksionimit dhe pas mbylljes së aktivitetit. Përdorimi i këtyre hapësirave lejohet vetëm kur është parashikuar në planin e menaxhimit të mbetjeve minerare dhe është miratuar nga institucioni përgjegjës.

- **KREU VII "GARANCIA FINANCIARE DHE MBIKËQYRJA"**

Neni 20 përcakton detyrimin për garancinë financiare. Operatori është i detyruar të vendosë garanci financiare përpara fillimit të ndërtimit ose operimit të objektit të mbetjeve minerare; pa të, veprimtaria e menaxhimit të mbetjeve minerare nuk mund të fillojë. Garancia financiare ka për qëllim të sigurojë disponueshmërinë e fondeve të nevojshme për: rehabilitimin dhe rikultivimin e territorit të prekur; mbylljen e objektit të mbetjeve minerare; monitorimin, mirëmbajtjen dhe kontrollin gjatë periudhës së pasmbylljes; si dhe zbatimin e masave të nevojshme për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe mjedisit, në rast se operatori nuk përmbush detyrimet e tij.

Neni 21 përcakton mënyrën e përcaktimit të garancisë financiare. Vlera e saj përcaktohet mbi bazën e: kategorisë dhe karakteristikave të objektit të mbetjeve minerare; natyrës, sasisë dhe rrezikshmërisë së mbetjeve minerare; kostove të rehabilitimit, rikultivimit, mbylljes dhe monitorimit pas mbylljes; si dhe kostove të masave që mund të nevojiten për mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit të njerëzve. Garancia financiare duhet të jetë e mjaftueshme për të siguruar që të gjitha detyrimet e operatorit sipas ligjit të përmbushen në çdo kohë dhe përditësohet çdo 2 vjet me çmimet e tregut dhe indeksimin sipas inflacionit.

Neni 22 përcakton rastet e përditësimit të garancisë financiare, përveç përditësimit dypjeçar: kur ndryshon plani i menaxhimit të mbetjeve minerare; kur ndryshon kategoria ose kapaciteti i objektit; kur ndryshojnë kostot e rehabilitimit, mbylljes ose monitorimit; si dhe kur kërkohet nga struktura përgjegjëse, bazuar në rezultatet e monitorimit ose inspektimit. Operatori paraqet dokumentin e garancisë financiare të përditësuar brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit të rivlerësimit, ndërsa struktura përgjegjëse verifikon periodikisht nëse garancia mbetet e mjaftueshme për të mbuluar detyrimet e operatorit.

Neni 23 përcakton përgjegjësinë mjedisore të operatorit për dëmet e shkaktuara në mjedis si rezultat i menaxhimit të mbetjeve minerare, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit. Kjo dispozitë lidhet me regjimin e përgjegjësisë mjedisore të vendosur në legjislacionin vendor dhe i përgjigjet parimeve të Direktivës 2004/35/KE për përgjegjësinë mjedisore.

- **KREU VIII "INSPEKTIMI, MONITORIMI DHE RAPORTIMI"**

Neni 24 përcakton regjimin e inspektimit të objekteve të mbetjeve minerare. Struktura përgjegjëse kryen inspektime të objekteve përpara fillimit të depozitimit të mbetjeve dhe, më pas, gjatë fazës së operimit, mbylljes dhe pasmbylljes, çdo 6 muaj si dhe inspektime të jashtëzakonshme, për të verifikuar përputhshmërinë e objekteve me kërkesat e ligjit, të akteve nënligjore dhe të kushteve të lejes. Inspektimet kryhen gjatë ndërtimit, kolaudimit, operimit, mbylljes dhe periudhës së pasmbylljes.

Neni 25 përcakton regjimin e raportimit. Operatori paraqet pranë strukturës përgjegjëse, çdo 6 muaj kalendarikë dhe jo më vonë se data 15 e muajit që vijon pas gjashtëmujorit përkatës, informacion mbi monitorimin e objektit të mbetjeve minerare, i cili përfshin të dhëna mbi: stabilitetin e objektit; cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, sipas rastit; funksionimin e sistemeve të mbrojtjes së mjedisit; rezultatet e monitorimit; si dhe aksidentet, incidentet dhe masat korrigjuese të marra. Forma dhe përmbajtja e raporteve përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për veprimtarinë minerare.

- **KREU IX “KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE, PEZULLIMI DHE REVOKIMI”**

Ky kre përcakton kuadrin sanksionues, që përbën një element kyç për zbatimin efektiv të ligjit. Sistemi kombinon gjobat administrative me masat e pezullimit dhe të revokimit të lejes, të aplikuara gradualisht sipas rëndësisë dhe përsëritjes së shkeljeve.

Neni 26 përcakton kundërvajtjet administrative dhe gjobat përkatëse: kryerja e veprimtarisë së menaxhimit të mbetjeve pa leje dënohet me gjobë 2 000 000 (dy milionë) lekë; mosrespektimi i detyrimeve dhe kushteve të lejes, të lidhura me mosrespektimin e planit të menaxhimit të mbetjeve minerare — me gjobë 500 000 (pesëqind mijë) lekë; shkelja e dispozitave të pikave 6 dhe 7 të nenit 6 — me gjobë 500 000 (pesëqind mijë) lekë; shkelja e dispozitave të pikave 5 dhe 8 të nenit 6 — me gjobë 1 000 000 (një milion) lekë; si dhe shkelja e detyrimit të raportimit sipas pikës 1 të nenit 25 — me gjobë 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

Neni 27 rregullon pezullimin e lejes, që vendoset kur shkelet ndonjë nga dispozitat e përcaktuara të nenit 6 të ligjit. Shkeljet që bëhen shkak për pezullim konstatohen nga punonjësit e strukturës përgjegjëse dhe i njoftohen menjëherë subjektit, me përshkrimin e arsyes së pezullimit. Pezullimi shoqërohet me lënien e detyrave për korrigjimin e shkeljeve, të cilat zbatohen nga operatori brenda afatit të pezullimit; struktura përgjegjëse verifikon korrigjimin jo më vonë se 10 ditë nga data e lënë për korrigjim.

Neni 28 përcakton shkaqet e revokimit të lejes, që përfshijnë: konstatimin e të dhënave të rreme në dokumentacionin e paraqitur për lejen ose mosplotësimin e kushteve të lejimit nga operatori; pezullimin ose ndërprejen e veprimtarisë pa miratimin e ministrisë; braktisjen e objektit të menaxhimit të mbetjeve; mosparaqitjen e garancisë financiare të rivlerësuar brenda afatit prej 30 ditëve; mosrespektimin e kërkesave të planit të menaxhimit të mbetjeve; moskryerjen e detyrave të lëna nga struktura përgjegjëse brenda afateve të vendimit të pezullimit; mosparaqitjen e informacioneve të kërkuara, paraqitjen e informacioneve të pavërteta ose pengimin e strukturës përgjegjëse në ushtrimin e inspektimit; revokimin e lejes mjedisore nga organi kompetent; si dhe shkeljen e dispozitave të

nenit 6 që lidhen me rrezikimin e jetës dhe shëndetit të banorëve apo me depozitimin e mbetjeve jashtë planit.

Neni 29 përcakton procedurën e revokimit, që fillon, si rregull, me raportin e propozimit të strukturës përgjegjëse ose me kërkesë të operatorit. Ministri njofton operatorin për qëllimin e revokimit dhe arsyen e tij, ndërsa operatori ka të drejtë të paraqesë sqarime brenda 30 ditëve kalendarike; nëse paraqiten argumente dhe prova të mjaftueshme për mungesën e shkaqeve, ministri vendos pushimin e procedurës.

Neni 30 përcakton detyrimet e operatorit pas revokimit të lejes: operatori detyrohet të zbatojë planin e rehabilitimit; zbatimi i sanksioneve administrative të pezullimit apo revokimit nuk e liron operatorin nga detyrimet e ligjit dhe nga përgjegjësia civile për dëmin e shkaktuar; si dhe, në rast revokimi, ministri ndjek pa kufizim çdo të drejtë ligjore dhe ndërmerr çdo veprim ligjor për të kërkuar dëmshpërblimin për dëmet e shkaktuara shtetit nga shkeljet e operatorit. Kjo dispozitë siguron që humbja e lejes të mos kthehet në mjet për shmangien e detyrimeve mjedisore.

- **KREU X "OBJEKTET E MBYLLURA DHE TË BRAKTISURA TË MBETJEVE MINERARE"**

Ky kre i kushtohet trashëgimisë minerare, një prej shtyllave më të rëndësishme të projektligjit në kontekstin shqiptar.

Neni 31 përcakton krijimin, administrimin dhe përditësimin, nga struktura përgjegjëse, të inventarit kombëtar të objekteve të mbyllura dhe të braktisura të mbetjeve minerare që mund të paraqesin rrezik për shëndetin e njerëzve ose mjedisin. Inventari përmban të paktën: vendndodhjen e objektit; llojin e mbetjeve minerare; vlerësimin paraprak të rrezikut; gjendjen teknike të objektit; si dhe masat e nevojshme për monitorim, rehabilitim ose sigurim. Inventari përditësohet periodikisht mbi bazën e monitorimeve, inspektimeve dhe të dhënave të reja, duke u kthyer në mjetin kryesor për njohjen e gjendjes, planifikimin e ndërhyrjeve dhe prioritizimin e investimeve publike.

Neni 32 përcakton se struktura përgjegjëse kryen ose urdhëron kryerjen e vlerësimit të rrezikut për objektet e mbyllura dhe të braktisura të mbetjeve minerare. Kur nga vlerësimi rezulton se objekti paraqet rrezik të konsiderueshëm për shëndetin e

njerëzve ose mjedisin, struktura përgjegjëse propozon marrjen e masave për monitorimin, rehabilitimin dhe sigurimin e tij. Këto dy dispozita i japin shtetit, për herë të parë, një kornizë ligjore të qartë për menaxhimin e objekteve të mbetjeve minerare pa përgjegjës të identifikueshëm.

- **KREU XI "DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE"**

Neni 33 përcakton se, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, Këshilli i Ministrave dhe ministri përgjegjës miratojnë aktet nënligjore për zbatimin e tij, afat që siguron zbatimin e shpejtë dhe të plotë të kuadrit të ri.

Neni 34 përcakton se operatorët që, në datën e hyrjes në fuqi të ligjit, ushtrojnë veprimtari të menaxhimit të mbetjeve minerare janë të detyruar të përshtatin veprimtarinë e tyre me kërkesat e këtij ligji brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e tij. Ky afat kalimtar balancon nevojën për përafrim të shpejtë me kohën e nevojshme teknike për përshtatje.

Neni 35 përcakton shfuqizimet dhe ndryshimet në legjislacionin në fuqi, të domosdoshme për të shmangur mbivendosjet dhe për të siguruar koherencën e kuadrit ligjor. Në ligjin nr. 10304, datë 15.07.2010, "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, shfuqizohen dispozitat që rregullonin deri më sot menaxhimin e mbetjeve minerare dhe planin përkatës të menaxhimit (përfshirë pikat 17 dhe 18 të nenit 36, nenin 38, si dhe referencat përkatëse në nenet 17, 18, 27, 29, 36, 37, 45 dhe 47), pasi këto çështje rregullohen tashmë në mënyrë të plotë dhe të specializuar me këtë ligj; njëkohësisht, pika 1 e nenit 31 ndryshohet për të harmonizuar regjimin e garancisë financiare për rehabilitimin e mjedisit me garancinë për mbylljen dhe rehabilitimin e sheshit të depozitimit të mbetjeve, e cila përcaktohet sipas legjislacionit për menaxhimin e mbetjeve minerare.

- **ANEKSET**

Aneksi I përcakton politikën për parandalimin e aksidenteve të rënda dhe informacionin që i vihet në dispozicion publikut. Politika për parandalimin e aksidenteve të rënda dhe sistemi i menaxhimit të sigurisë hartohen në përputhje me rrezikun e paraqitur nga objekti i mbetjeve minerare të Kategorisë A dhe përcaktojnë objektivat, parimet dhe masat e operatorit për identifikimin, parandalimin dhe kontrollin e rreziqeve të aksidenteve të rënda.

Aneksi II përcakton kërkesat për karakterizimin e mbetjeve që do të depozitohen, me qëllim garantimin e stabilitetit fizik dhe kimik afatgjatë të strukturës së venddepozitimit dhe parandalimin e aksidenteve të rënda. Karakterizimi përfshin: përshkrimin e karakteristikave fizike dhe kimike të mbetjeve në afat të shkurtër dhe të gjatë, duke marrë parasysh llojin e mineralit dhe kushtet atmosferike; mbledhjen dhe vlerësimin e informacionit ekzistues dhe, kur ai mungon, marrjen e mostrave sipas standardit EN 14899; kërkesat teknike për përcaktimin e karakteristikave kimike, mineralogjike dhe gjeokimike, përfshirë testet e tretshmërisë së metaleve dhe, për mbetjet që përmbajnë sulfide, testet statike ose kinetike për drenimin acid të shkëmbinjve; konsideratat e përgjithshme të vendburimit; përshkrimin e mbetjeve dhe të trajtimit të parashikuar të tyre, përfshirë origjinën, sasinë, sistemin e transportit, substancat kimike të përdorura dhe klasifikimin e tyre; sjelljen gjeoteknike të mbetjeve, përmes parametrave fiziko-mekanikë; klasifikimin e mbetjeve sipas zërave përkatës të Vendimit 2000/532/KE, duke pasur parasysh veçanërisht karakteristikat e rrezikshmërisë; si dhe metodat e depozitimit dhe sistemet e transportit të mbetjeve.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Këshilli i Ministrave; Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, si ministria përgjegjëse për veprimtarinë minerare; strukturat përgjegjëse në varësi të saj, të cilat ushtrojnë funksionet e monitorimit dhe inspektimit në fushën e menaxhimit të mbetjeve minerare; Qendra Kombëtare e Biznesit, për dhënien e lejeve; si dhe njësitë e qeverisjes vendore, në kuadër të procesit të konsultimit publik.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është hartuar dhe propozuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), Shërbimin Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH), Autoritetin Kombëtar për

Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera dhe Qendrën Rajonale e Inovacionit të Institucionit Evropian të Teknologjise dhe Inovacionit për Lëndet e Para.

Në procesin e hartimit janë marrë parasysh praktikat më të mira të vendeve të Bashkimit Evropian në fushën e menaxhimit të mbetjeve minerare, si dhe kërkesat e Direktivës 2006/21/KE.

Projektvendimi do të dërgohet për mendim tek ministritë e linjës, nëpërmjet sistemit e-akte.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj nuk ka efekt të drejtpërdrejtë në buxhetin e shtetit. Kostot e menaxhimit të mbetjeve minerare, përfshirë rehabilitimin, rikultivimin, mbylljen dhe monitorimin pas mbylljes së objekteve, mbulohen nga operatorët, në zbatim të parimit "ndotësi paguan", përmes detyrimit për vendosjen e garancive financiare. Funksionet e strukturës përgjegjëse për monitorimin dhe inspektimin ushtrohen brenda strukturave dhe buxheteve ekzistuese të ministrisë përgjegjëse për veprimtarinë minerare.

MINISTRI

Enea Karakaçi

Enea Karakaci

Digitally signed by Enea Karakaci
DN: c=AL, l=Tirane, o=Ministria e Infrastruktures dhe Energjise, title=Minister, cn=Enea Karakaci
Date: 2026.10.23 10:58:23 +02'00'